

SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË

RREGULLORE E KONTROLLIT TË CILËSISË

Funksioni propozues	Këshilli Drejtues
Funksioni aprovues	Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve
Data e aprovimit	24.10.2020

I. TË PËRGJITHSHME

1. Të gjithë Kontabilistët e Miratuar dhe shoqëritë e kontabilitetit që janë të anëtarësuar në **Shoqatën e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë** (në vijim “**Shoqata**” ose “**SHKFESH**”) i nënshtrohen sistemit të kontrollit të cilësisë të organizuar brenda Shoqatës, i cili ka si qëllim dhënien e sigurisë për cilësinë e shërbimeve të kontabilitetit, dhënien e sigurisë mbi uniformitetin dhe saktësinë e informacionit financiar të njësive ekonomike dhe përfundimisht promovimin e interesit publik nëpërmjet cilësisë së lartë të shërbimeve të kontabilitetit.
2. Sistemi i kontrollit të cilësisë bazohet në parimet dhe rregullat e vendosura në këtë rregullore dhe akte të tjera të Shoqatës, në parashikimet ligjore relevante dhe normat rregullative të përcaktuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
3. Kjo rregullore miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të SH.K.F.SH. dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

II. TERMAT

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato në “Ligjin për Auditimin”, aktet rregullatore të BMP dhe Statutin e Shoqatës.

III. E DREJTA PËR KONTROLLIN E CILËSISË

1. Të drejtën e kryerjes së kontrollit të cilësisë për KM-të dhe shoqëritë e kontabilitetit anëtare të SH.K.F.SH. e ka vetë Shoqata në përputhje me Statutin dhe këtë rregullore dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore.
2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike mund të delegojë kryerjen e kontrollit të cilësisë së shërbimeve të kontabilitetit të SH.K.F.SH., e cila siguron që kontrolli të jetë i pavarur nga kontabilistët e miratuar dhe shoqëritë e kontabilitetit që kontrollohen.

IV. DETYRIMI PËR T’IU NËNSHTRUAR KONTROLLIT PËR CILËSINË E SHËRBIMEVE

1. Kontrolli i cilësisë është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët e Shoqatës, KM apo shoqëritë e kontabilitetit, vendase apo të huaja.

2. Refuzimi apo pengimi nga anëtarët për t'iu nënshtruar kontrollit përbën shkelje të rregullave të parashikuara në Kodin e Etikës të SH.K.F.SH. dhe shkak për nisjen e procedurave disiplinore në përputhje me rregulloret e posaçme.
3. Kontrolli i cilësisë kryhet pranë vendndodhjeve të KM-ve ose shoqërive të kontabilitetit, që janë subjekte të kontrollit të cilësisë dhe, kur gjykohet e nevojshme nga Komisioni i Kontrollit të Cilësisë, edhe në mjediset e Shoqatës, ku dhe kërkohet paraqitja e dokumentacionit të nevojshëm.

V. SISTEMI I KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Për të garantuar cilësinë e shërbimeve të kontabilitetit të dhëna nga anëtarët e SH.K.F.SH., ngrihet dhe funksionon sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë.
2. Ky sistem organizohet në mënyrë të atillë që të jetë i pavarur nga KM-të apo shoqëritë e kontabilitetit, subjekte të kontrollit.
3. Strukturat përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e praktikës së kontrollit të cilësisë brenda Shoqatës janë:
 - a) Këshilli Drejtues;
 - b) Komisioni i Kontrollit të Cilësisë;
 - c) Kontrolluesit e përzgjedhur rast pas rasti nga Komisioni i Kontrollit të Cilësisë me miratimin e Këshillit Drejtues, për realizimin e procedurave të kontrollit të anëtarëve KM dhe shoqëri kontabiliteti.
4. Sistemi i kontrollit të cilësisë përmbush këto objektiva:
 - a) kontrollin e cilësisë (në nivel individual) të shërbimeve të ofruara nga kontabilistët e miratuar; dhe
 - b) kontrollin e cilësisë, që organizohet brenda shoqërisë së kontabilitetit/personit fizik.
5. Objekt i kontrollit të cilësisë janë veprimtaritë profesionale të kontabilistëve të miratuar dhe organizimi i kontrollit të cilësisë të shoqërive të kontabilitetit, vendase dhe të huaja.
6. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë, nën mbikëqyrje e Këshillit Drejtues, realizon kontrollin e cilësisë bazuar në Ligjin e Auditimit dhe rregulloret e BMP dhe në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, si dhe me kërkesat ligjore e nënligjore dhe rregullat e tjera të brendshme të Shoqatës.
7. Për realizimin e kontroleve individuale, kontrolluesit bazohen në metodologjinë e kontrollit të miratuar nga SH.K.F.SH.

VI. PËRGJEGJËSIA E KONTABILISTËVE TË MIRATUAR PËR SIGURIMIN E CILËSISË

1. Kontrolli i cilësisë në nivel individual të KM-ve garantohej nga zbatimi prej kontabilistit të miratuar të të gjithë kërkesave të përshkruara në të gjithë standardet e kontabilitetit, të cilat janë të zbatueshme në kontekstin e shërbimit të kontabilitetit përkatës.
2. Kontabilistët e miratuar ndjekin me rigorozitet standardet dhe principet e Kodit të Etikës të Shoqatës për çdo shërbim të ofruar.
3. Kontabilistët e miratuar që i nënshtrohen kontrollit, bashkëpunojnë me kontrolluesit dhe Komisionin e Kontrollit të Cilësisë dhe u përgjigjen kërkesave për dokumentacion dhe informacion brenda afateve të përcaktuara në to, duke dhënë edhe sqarime, verbale apo me shkrim, kur kërkohet.

VII. PËRGJEGJËSITË E SHOQËRIVE TË KONTABILITETIT PËR SIGURIMIN E CILËSISË

1. Shoqëritë e kontabilitetit, anëtare të Shoqatës, organizojnë brenda tyre sistemin e kontrollit të cilësisë në përputhje me parimet dhe standardet e IFAC, duke përcaktuar rregulla të brendshme për rishikimin e cilësisë së shërbimeve.
2. Shoqëritë zbatojnë forma të përshtatshme organizimi brenda tyre, që u përgjigjen nevojave të ushtrimit të profesionit.
3. Shoqëritë e kontabilitetit përgatitin dhe, kur kërkohet, u paraqesin kontrolluesve dhe Komisionit të Kontrollit të Cilësisë politikën e brendshme të kontrollit të cilësisë dhe metodologjinë që përdor shoqëria për kontrollin e cilësisë.
4. Ortakët/partnerët/aksionerët dhe drejtuesit e shoqërisë së kontabilitetit, që janë kontabilistë të miratuar, sigurohen që shërbimet e ofruara nga shoqëria janë në përputhje me standardet dhe rregullat e aplikueshme dhe principet e Kodit të Etikës të Shoqatës, duke mbikëqyrur cilësinë e punës së individëve brenda shoqërisë që ofrojnë këto shërbime.

VIII. KRIJIMI DHE PËRBËRJA E KOMISIONIT TË KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Shoqata krijon Komisionin e Kontrollit të Cilësisë, si strukturë e posaçme përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e kontrollit të cilësisë së shërbimeve të kontabilitetit të dhëna prej anëtarëve.
2. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë përbëhet nga pesë KM, anëtarë të Shoqatës, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i Shoqatës për një periudhë trevjeçare, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.
3. Këshilli Drejtues emëron si Kryetar të Komisionit njërin nga anëtarët. Anëtarët e Komisionit, por jo më shumë se tre, mund të jenë gjithashtu anëtarë në Këshillin Drejtues.
4. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë është strukturë në varësi të Këshillit Drejtues të SH.K.F.SH., që vepron në përputhje me parashikimet në këtë rregullore dhe akte të tjera të Shoqatës për sigurimin e kontrollit të cilësisë.

IX. DETYRAT E KOMISIONIT TË KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë ka këto të drejta e detyra kryesore:
 - a) Instrukton dhe trajnon kontrolluesit dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre të kontrollit;
 - b) Harton procedurat e përzgjedhjes së kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit që do t'i nënshtrohen kontrollit të cilësisë;
 - c) Harton manualin/e për kontrollin, bazuar në udhëzimet e publikuara BMP ose Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve, që, pasi miratohen nga Këshilli Drejtues, u bëhen të njohura kontrolluesve dhe anëtarëve, të cilët mund të jenë subjekte të kontrollit.
 - d) Harton programin vjetor të kontrollit të cilësisë, i cili parashikon edhe periodicitetin e kontrollit si dhe kohën e nevojshme për çdo kontroll, që paraqiten për miratim pranë Këshillit Drejtues;
 - e) Harton procedurat e përzgjedhjes së dosjeve që do të kontrollohen dhe e paraqet për miratim pranë Këshillit Drejtues;
 - f) Harton procedurat e përzgjedhjes së kontrolluesve dhe listën vjetore të kontrolluesve, të cilat miratohen nga Këshilli Drejtues;
 - g) Përcakton koston e kontroleve pasi konsultohet me Drejtorin Ekzekutiv të Shoqatës;
 - h) Cakton anëtarët që do të kontrollohen, kontrolluesit e tyre, si dhe kërkon të dhëna për shërbimet e kryera nga KM apo shoqëritë e kontabilitetit që do t'i nënshtrohen kontrollit;

- i) Vlerëson materialet dhe konkluzionet e kontrolluesve dhe, bazuar në rezultatet e kontrollit, u propozon organeve të Shoqatës marrjen e masave ndaj anëtarëve subjekte kontrolli;
- j) Vlerëson materialet dhe konkluzionet e kontrolluesve dhe lëshon rekomandime për përmirësim ndaj anëtarëve të kontrolluar si dhe ndjek zbatimin e tyre;
- k) Harton modelin e raportit/ve në lidhje me kontrollin e cilësisë, të cilat i paraqiten për miratim Këshillit Drejtues;
- l) I paraqet çdo tremujor Këshillit Drejtues rezultatet dhe raportet e kontrolleve të kryera për tremujorin paraardhës;
- m) Harton modelin e Deklaratës së Konfidencialitetit në lidhje me kontrollin e cilësisë, për t'u nënshkruar nga kontrolluesit përpara kryerjes së kontrolleve;
- n) Organizon trajnimin e kontrolluesve pasi konsultohet me Drejtorin Ekzekutiv mbi kostot e trajnimit.

X. FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Komisioni mblidhet në ambientet e SH.K.F.SH., minimalisht një herë në muaj, në datën e njoftuar nga Kryetari dhe sa herë kërkohet prej tij.
2. Komisionit i caktohet një hapësirë e përshtatshme në zyrat e Shoqatës për përmbushjen e detyrave të veta dhe asistohet nga sekretaria e Shoqatës, duke paraqitur kërkesë për suport dhe ndihmë teknike dhe materiale pranë Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës.
3. Mbledhjet drejtohen nga Kryetari i Komisionit dhe në mungesë të këtij, mbledhjet drejtohen nga njëri prej anëtarëve.
4. Mbledhjet janë të vlefshme nëse të pranishëm janë më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit të Kontrollit të Cilësisë, të cilët marrin vendime me shumicë të thjeshtë për të gjitha çështjet që janë në kompetencë të tyre.

XI. LIRIMI DHE SHKARKIMI I ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Anëtari i Komisionit të Kontrollit të Cilësisë lirohet nga detyra në rastet kur:
 - a) mbaron mandati;
 - b) jep dorëheqjen;

- c) çregjistrohet nga regjistri publik, ose ka pezulluar përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë si kontabilist i miratuar;
2. Këshilli Drejtues i SH.K.F.SH. ka të drejtë të shkarkojë një anëtar të Komisionit të Kontrollit të Cilësisë, kur:
- a) nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhjet e Komisionit për më shumë se katër herë radhazi;
 - b) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë e kontrollit dhe cilësinë e shërbimeve;
 - c) nuk përmbush funksionet e parashikuara kjo rregullore dhe akte të tjera të detyrueshme;
 - d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - e) për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
 - f) për shkelje të kuadrit rregullator në fuqi.
3. Këshilli Drejtues, në rastet kur anëtari i Komisionit lirohet, shkarkohet, dorëhiqet apo vdes, duhet të caktojë një zëvendësues, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data e njoftimit të lirimit, shkarkimit, dorëheqjes apo vdekjes, në përputhje me procedurat e përzgjedhjes.
4. Mandati (trevjeçar) i zëvendësuesit llogaritet nga dita e emërimit të tij nga Këshilli Drejtues sipas pikës 3 më sipër.
5. Anëtarët e Komisionit të Kontrollit të Cilësisë kanë të drejtën e shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve në masën e përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

XII. RREGULLAT E PROCESIT TË KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Kontrolli për cilësinë shtrihet mbi tërësinë e organizimit dhe të veprimtarisë së kontabilistit të miratuar apo shoqërisë së kontabilitetit.
2. Kontrolli i cilësisë realizohet përmes kontrollit të dosjeve të shërbimeve përkatëse të kontabilitetit, të përcaktuara në programin vjetor të kontrollit dhe përfshin një vlerësim të pajtueshmërisë me standardet e zbatueshme të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit të pasqyrave financiare, me kërkesat e etikës dhe të pavarësisë.
3. Të dhënat financiare të brendshme të KM-së apo shoqërisë së kontabilitetit nuk përbëjnë në vetvete objekt të këtij kontrolli, por kontrolluesit i njihet e drejta për t'u njohur me informacionin financiar për të verifikuar që honoraret dhe tarifimi i shërbimeve u përgjigjet shërbimeve të kryera dhe që burimet njerëzore dhe materiale u përgjigjen nevojave të përfituesit të shërbimeve të kontabilitetit.
4. Kontrolluesi, për çdo kontroll, mban procesverbal të dokumenteve të shqyrtuara, i cili nënshkruhet prej tij dhe anëtarit dhe bëhet pjesë e dosjes së kontrollit.

5. Gjatë kontrollit vlerësohet edhe cilësia dhe sasia e burimeve të shpenzuara, të tarifave të ngarkuara për shërbimet.
6. Në rastin e shoqërive të kontabilitetit, kontrolli përfshin edhe vlerësimin e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë të shoqërisë së kontabilitetit.

XIII. PERIODICITETI I KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Kontrolli i cilësisë realizohet nëpërmjet kontrolluesve të paktën:
 - a) 1 herë në çdo 4 vjet për të gjithë anëtarët që kanë mbi 5 vjet veprimtari në profesion;
 - b) 1 herë në 2 vjet për anëtarët që kanë më pak se 5 vjet si ushtrues të profesionit.

XIV. PËRZGJEDHJA E KONTROLLUESVE

1. Kontrolluesit duhet të jenë anëtarë KM, që dallohen për nivelin e tyre profesional, integritet dhe objektivitet në gjykim.
2. Për t'u përzgjedhur si kontrollues, KM duhet të ketë të paktën 3 vjet eksperience dhe gjatë kësaj periudhe ndaj tyre nuk janë marrë masa disiplinore nga BMP apo nga Shoqata.
3. Përzgjedhja e kontrolluesve për kontrollin e cilësisë bëhet nga Komisioni i Kontrollit të Cilësisë, në bazë të një procedure objektive, e cila jep garanci se nuk ka konflikt interesash ndërmjet kontrolluesit dhe KM-së ose shoqërisë së kontabilitetit, e cila do të kontrollohet.
4. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë paraqet pranë Këshillit Drejtues listën e kontrolluesve për t'u angazhuar në programin e kontrollit.
5. Anëtarët e Këshillit Drejtues, anëtarët e Komisionit të Kontrollit të Cilësisë, si dhe anëtarët e Komisionit Disiplinor, nuk mund të veprojnë si kontrollues.
6. KM-të e përzgjedhur dhe miratuar sipas listës në pikën 4, konsiderohet se kanë bërë shkelje disiplinore kur refuzojnë ose tërhiqen nga kryerja e kontrollit, përveçse për arsye të argumentuara, të cilat pranohen si shkaqe për mospërfshirjen në kontroll nga Këshilli Drejtues, i cili merr vendim brenda 2 javësh nga paraqitja e kërkesës.
7. Në caktimin e kontrolluesve mbahen parasysh njohuritë profesionale specifike, aftësitë për të përmbushur detyrën, si dhe pavarësia në raport me ekspertin që do të kontrollohet.
8. Nuk autorizohet kontrolli midis kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit ku ata janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar deri para 5 vitesh.

XV. LISTA E SUBJEKTEVE DHE PROGRAMI VJETOR I KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Brenda datës 28 shkurt të çdo viti, Komisioni i Kontrollit të Cilësisë i propozon dhe paraqet pranë Këshillit Drejtues për miratim, programin vjetor të kontrollit, i cili përmban:
 - a) listën e KM-ve dhe shoqërive të kontabilitetit që do t'i nënshtrohen kontrollit të cilësisë;
 - b) kalendarin i kontrolleve (datat e kontrolleve) për periudhën deri më 31 dhjetor të vitit përkatës;
 - c) kategoritë e shërbimeve të kontabilitetit (dosjeve) që do të jenë objekt kontrolli.
2. Këshilli Drejtues miraton programin dhe listën në pikën 1 brenda datës 1 prill ose ia kthen atë Komisionit për ndryshime të argumentuara.
3. Në rast se lista/programi kthehet nga Këshilli për ndryshime, Komisioni riparaqet programin dhe propozimet e shërbimeve për kontroll brenda 2 javësh nga dita e kthimit pranë Këshillit, i cili merr vendim për miratimin e tyre brenda 1 muaji nga data e riparaqitjes.

XVI. AFATET DHE DETYRAT PËR KONTROLLIN E ANËTARIT

1. Afatet për realizimin e kontrollit duhet t'u përmbahen afateve të përcaktuara në kalendarin e miratuar nga Këshilli Drejtues dhe në pajtim me programin e kontrollit të Komisionit të Kontrollit të Cilësisë.

XVII. PAVARËSIA E KONTROLLUESIT

1. Kontrolluesi duhet të përmbushë detyrën e tij në mënyrë të pavarur. Ai kryen verifikimet që i gjykon të nevojshme dhe përgatit raportin objektivisht, bazuar në faktet e konstatuara dhe gjykimin e tij personal.
2. Kontrolluesi nuk ndikohet apo t'i sugjerohen qëndrime në lidhje me gjetjet e kontrollit. Ai parashtron faktet dhe mendimin e tij bazuar në fakte.

XVIII. DETYRAT E KONTROLLUESVE GJATË KONTROLLIT

1. Pavarësisht detyrave të caktuara nga Komisioni i Kontrollit të Cilësisë, në programin e kontrollit të miratuar nga Këshilli Drejtues, gjatë çdo kontrolli, kontrolluesit duhet të shqyrtojnë çështjet që kanë të bëjnë me:
 - a) respektimin e kërkesave ligjore;
 - b) respektimin dhe zbatimin rigoroz të standardeve të aplikueshme të kontabilitetit për shërbimin përkatës;
 - c) përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të cilësisë të brendshëm të shoqërisë së kontabilitetit;
 - d) në rastin e shoqërive të kontabilitetit, formimin e vijueshëm profesional të të punësuarve në shoqëri dhe ortakëve/partnerëve/aksionerëve KM;
 - e) respektimin e rregullave dhe të normave të etikës profesionale dhe veçanërisht për sa i përket papajtueshmërisë me standardet profesionale dhe me kërkesat e pavarësisë.

XIX. RIKONTROLLET

1. Rikontrollet e autorizuar brenda periudhës së parashikuar në Seksionin XIII të kësaj rregulloreje aprovohen në rastet kur Komisioni i Kontrollit të Cilësisë krijon bindjen se anëtar i përkatës nuk i ka ndjekur rekomandimet e dhëna për kontrollin e mëparshëm.
2. Në rastin e rikontrolleve, do të ndiqen të njëjtat procedura dhe rregulla që zbatohen edhe për kontrollin.

XX. E DREJTA E AKSESIT

1. Kontrolluesi ka të drejtën e aksesit në informacione dhe dokumentacionin që i përket kategorisë së shërbimeve, të miratuara sipas programit të kontrollit.
2. Kontrolluesi mund të njihet edhe me informacione/dokumente që ai e gjykon të nevojshme për kryerjen e kontrollit dhe të kërkojë sqarime ndaj anëtarit.
3. Kontrolluesi vë në dijeni menjëherë Komisionin Disiplinor dhe Këshillin Drejtues për anëtarin, që nuk lejon aksesimin e informacionit ose që pengon në marrjen e tij.

XXI. RAPORTI I KONTROLLIT

1. Në përfundim të kontrollit, kontrolluesi i cilësisë përgatit një raport, i cili përmban gjetjet faktike dhe konkluzionet kryesore të arritura gjatë kryerjes së kontrollit.
2. Në përfundim të kontrollit të cilësisë kontrolluesi/t hartojnë një raport, i cili i paraqitet Komisionit të Kontrollit të Cilësisë jo më vonë se 2 javë kalendarike nga përfundimi i kontrollit përkatës.
3. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë shqyrton raportin dhe kur e shikon të përshtatshme përgatit rekomandime për përmirësim ose kur konstaton shkelje të rënda e kalon rastin pranë Këshillit Drejtues, i cili merr vendim brenda 3 javësh kalendarike për kalimin e rastit për shqyrtim pranë Komisionit Disiplinor.
4. Para se të miratojë rezultatet e kontrollit, Komisioni i Kontrollit të Cilësisë, bazuar në rezultatet e kontrollit, rishikon dosjet e KM-ve ose shoqërive të kontabilitetit kur kjo gjykohet e nevojshme.
5. Raporti i kontrollit përgatitet në përputhje me Metodologjinë e Kontrollit të Cilësisë dhe duhet të përmbajë minimalisht:
 - a) informacion mbi mënyrën se si është kryer kontrolli;
 - b) një përshkrim dhe vlerësim të përgjithshëm të dosjeve të shqyrtuara;
 - c) një përshkrim të mënyrës së mbajtjes së dosjeve dhe të cilësisë së shërbimit
 - d) dobësitë dhe neglizhencat e konstatuara;
 - e) një vlerësim mbi përshtatshmërinë e burimeve njerëzore e materiale;
 - f) konstatime pozitive ose rekomandimet për përmirësim dhe për veprimet që priten të ndërmerren në lidhje me rekomandimet e dhëna, ose, kur është rasti, propozimin e marrjes së masave ndaj anëtarit.
6. Raporti i Kontrollit i vihet në dispozicion anëtarit subjekt kontrolli brenda një jave nga data e dokumentit.

XXII. MOSMARRËVESHJET

1. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet kontrolluesit dhe të kontrolluarit, i kontrolluari mund të kërkojë që mosmarrëveshja të gjykohet nga Komisioni i Kontrollit të Cilësisë, pasi

anëtari i kontrolluar ka paraqitur formalisht qëndrimet e tij. Për anëtarët shoqëri kontabiliteti, zbatohen rregullat e përfaqësimit.

2. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë organizon një mbledhje me praninë e kontrolluesit dhe të të kontrolluarit dhe, pasi merr qëndrimet dhe shpjegimet e palëve, merr vendim në lidhje me kontrollin.

XXIII. VENDIMET E KOMISIONIT TË KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë, pasi shqyrton raportin e kontrollit dhe nëse është rasti edhe dosjen përkatëse, merr vendim për rastin, duke miratuar rekomandimet dhe propozimet në raportin e kontrolluesit ose vendos vetë rekomandimet dhe propozimet për marrjen e masave ndaj anëtarit.
2. Anëtari njoftohet për vendimin e marrë nga Kontrolli i Cilësisë sipas pikës 1 dhe pajiset me kopje të tij.
3. Vendimet e Komisionit të Kontrollit të Cilësisë, kur parashikojnë propozimin për marrjen e masave disiplinore ndaj anëtarit, i njoftohen Komisionit Disiplinor dhe Këshillit Drejtues brenda 1 jave nga marrja e vendimit.

XXIV. E DREJTA E ANKIMIMIT

1. Anëtari që i nënshtrohet procesit të kontrollit të cilësisë, ka të drejtën të ankohet ndaj vendimit të marrë brenda një periudhe 15-ditore nga marrja e vendimit pranë Këshillit Drejtues, duke paraqitur ankesë të argumentuar me shkrim dhe të shoqëruar me prova nëse është e nevojshme.
2. Këshilli Drejtues shprehet mbi ankesën me vendim brenda 2 muajve nga data e paraqitjes.
3. Kur e vlerëson të nevojshme, Këshilli Drejtues mbledh informacione shtesë nga ankuesi ose Komisioni i Kontrollit të Cilësisë.

XXIV. PËRGATITJA DHE PUBLIKIMI I RAPORTIT TË PËRGJITHSHËM TË KONTROLLIT TË CILËSISË

1. Komisioni i Kontrollit të Cilësisë përgatit rezultatet e përgjithshme të sistemit të kontrollit dhe merr masa për publikimin e përvitshëm të raportit në faqen zyrtare të Shoqatës sipas një formati të aprovuar nga Këshilli Drejtues.

2. Raporti i përgjithshëm vjetor nuk përmban emrat e anëtarëve të veçantë.

XXV. INFORMACIONI KONFIDENCIAL

1. Kontrolluesit dhe Komisioni i Kontrollit të Cilësisë mbrojnë informacionin e siguruar gjatë kontrollit, i cili është informacion konfidencial dhe kujdesen që ai të mos përhapet te të tretët.
2. Informacioni i siguruar gjatë kontrollit mund t'u bëhet i ditur vetëm organeve të parashikuara në rregullore dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike në përputhje me parashikimet ligjore.
3. Përhapja e informacionit konfidencial konsiderohet shkelje e rregullave të etikës dhe përbën shkak për fillimin e një procedure investigimi dhe disiplinore.

XXVI. MBIKËQYRJA E BMP

1. Sistemi i kontrollit të cilësisë të SH.K.F.SH. i nënshtrohet mbikëqyrjes së Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i cili shqyrton dhe vlerëson programet dhe raportet e kontrollit të cilësisë dhe aspekte të tjera të kontrollit të cilësisë.

XXVII. RISHIKIMI I RREGULLORES

1. Kjo rregullore rishikohet çdo vit nga Këshilli Drejtues me qëllim përafrimin e saj me normat dhe standardet më të mira ndërkombëtare për kontrollin e cilësisë.
2. Kur për këtë rregullore kërkohen ndryshime nga BMP apo ndryshimet diktohen si nevojë për shkak të ndryshimeve legjislative apo rregullatore, Këshilli Drejtues merr masat që të njoftohet Asambleja dhe të organizohet mbledhje e jashtëzakonshme për miratimin e ndryshimeve.
3. Ndryshimet e rregullores miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të SH.K.F.SH. në përputhje me parashikimet në Statut dhe nga BMP.